



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 3263 / Prot.
4

Tiranë, më 13 . 12 . 2024

VENDIM

Nr. 130 , datë 13 . 12 . 2024

**“PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT, TARIFAVE TË KONKURRIMIT
DHE TË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË
STUDIMEVE, SPECIALIZIME AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR
VITIN AKADEMIK 2024-2025, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 78, Statutit të UMT-së, neni 89, Rregullores së UMT-së, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e mjekësisë, e ndryshuar, si dhe bazuar në propozimet e njëjësive kryesore, përkatësisht të Fakultetit të Mjekësisë me shkresat nr.3899/27 prot., datë 21.11.2024 dhe nr. 3899/33 prot., datë 03.12.2024 dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare me shkresat nr. 705/3 prot., datë 25.11.2024 dhe nr. 705/12 prot., datë 03.12.2024, si dhe në Vendimin Nr. 21, datë 10.12.2024 të Rektoratit të UMT-së, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2024-2025, janë në total 307 (treqind e shtatë).
2. Kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Numri minimal i kuotave të pranimit në programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, është jo më pak se 5 (pesë) kuota.
4. Aplikojnë, për programe studimi specializuese afatgjata, të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.
5. Pranimet e studentëve në programin specializues afatgjatë sipas kuotave të miratuara në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën

e mjekësisë, e ndryshuar me Vendim nr.133, datë 26.12.2023 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

6. Tarifa e konkurrimit në programet specializuese afatgjatë apo tarifa e aplikimit për transferim studimesh është 5000 (pesëmijë) lekë. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është 115,000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë (tarifa e konkurrimit/aplikimit dhe tarifa e shkollimit është e njëjtë me tarifat e vitit të mëparshëm akademik). Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa këstet e tjera arkëtohen sipas afateve dhe masës në përqindje të përcaktuara nga fakultetet përkatëse. Studenti, i cilësuar, në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik, si përsëritës, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit, të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
7. Shpërndarja e kuotave të mbuluara të propozuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme, sipas çdo programi studimi, bëhet me vendim të Senatit Akademik. Studentët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara sipas kësaj pike të këtij vendimi, lidhin kontrata, me ministrinë përkatëse ku përcaktohen detyrimet mes palëve si dhe penalitetet, në rastet e mosrespektimit të tyre. Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj përcaktohen me urdhër të ministrit që mbulon fushën përkatëse dhe i bëhen të ditura kandidatit para hapjes së procesit të aplikimeve.
8. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara në pikën 7 të këtij vendimi, duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, një letër mbështetëse nga ministria përkatëse.
9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i njësive kryesore përkatëse, pa efekte buxhetore shtesë.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendrës së Shërbimeve Arsimore, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme, për vijimin e mëtejshëm të procedurave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për këto lloj programesh.
11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit të UMT-së, për miratimin e tarifave të propozuara në pikën 6 të këtij vendimi.




Tabela nr. 1. Kuotat e pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve “Specializim Afatgjatë” në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2024-2025.

Nr.	NJËSIA KRYESORE	PROGRAMI I STUDIMIT	KUOTA TË MIRATUARA PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025
1	F. MJEKËSISË	ALERGOLOGJI DHE IMUNOLOGJI KLINIKE	5
2	F. MJEKËSISË	ANATOMI PATOLOGJIKE	5
3	F. MJEKËSISË	ANESTEZI-REANIMACION	20
4	F. MJEKËSISË	DIAGNOZË ME IMAZHE	5
5	F. MJEKËSISË	DERMATOLOGJI DHE VENEROLOGJI	5
6	F. MJEKËSISË	ENDOKRINOLOGJI	5
7	F. MJEKËSISË	GASTROHEPATOLOGJI	7
8	F. MJEKËSISË	HEMATOLOGJI	5
9	F. MJEKËSISË	KARDIOKIRURGJI	5
10	F. MJEKËSISË	KARDIOLOGJI	8
11	F. MJEKËSISË	KIRURGJI E PËRGJITHSHME	20
12	F. MJEKËSISË	KIRURGJI PLASTIKE, RIKOSTRUKTIVE DHE ESTETIKE	5
13	F. MJEKËSISË	LABORATOR KLINIK-BIOKIMIK	5
14	F. MJEKËSISË	MIKROBIOLOGJI	5
15	F. MJEKËSISË	MJEKËSI FAMILJE	30
16	F. MJEKËSISË	MJEKËSI INTERNE	10
17	F. MJEKËSISË	MJEKËSI LIGJORE	5
18	F. MJEKËSISË	MJEKËSI URGJENCE	12
19	F. MJEKËSISË	MJEKËSI TRANSFUZIVL	5
20	F. MJEKËSISË	NEFROLOGJI	7
21	F. MJEKËSISË	NEUROLOGJI	5
22	F. MJEKËSISË	NEUROKIRURGJI	5
23	F. MJEKËSISË	OTORINOLARINGOLOGJI	5
24	F. MJEKËSISË	OBSTETRIKË-GJINEKOLOGJI	10
25	F. MJEKËSISË	OKULISTIKË	5
26	F. MJEKËSISË	ONKOLOGJI	8
27	F. MJEKËSISË	ORTOPEDI-TRAUMATOLOGJI	5
28	F. MJEKËSISË	PEDIATRI	20
29	F. MJEKËSISË	PNEUMOLOGJI	5
30	F. MJEKËSISË	PSIKIATRI	10
31	F. MJEKËSISË	PSIKIATRI E FEMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE	5
32	F. MJEKËSISË	REUMATOLOGJI	5
33	F. MJEKËSISË	SËMUNDJE INFEKTIVE	10
34	F. MJEKËSISË	SHËNDETËSBLIK	10
35	F. MJEKËSISË	TOKSIKOLOGJI KLINIKE	5
TOTAL FM			287
1	F. MJEKËSISË DENTARE	KIRURGJI ORO-MAXILOFACIALE	10
2	F. MJEKËSISË DENTARE	ORTODONCI	5
TOTAL FMD			15

*5 kuota të miratuara për transferim të studimeve në Fakultetin e Mjekësisë UMT, nga institucione jashtë shtetit

Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005 - Tiranë, web site: www.umed.edu.al; E-mail: info@umed.edu.al;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 582 / Prot.
2

Tiranë, më 10.03.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 31, datë 10.03.2025

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 130, DATË 13.12.2024
“PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT, TARIFAVE TË KONKURRIMIT
DHE TË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË
STUDIMEVE, SPECIALIZIME AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR
VITIN AKADEMIK 2024-2025, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË” I
NDRYSHUAR

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 78; Statutit të UMT-së, neni 89; Rregullores së UMT-së; Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e mjekësisë, e ndryshuar; Vendimit të Senatit Akademik të UMT-së nr.130, datë 13.12.2024 "Për miratimin e kuotave të pranimit, tarifave të konkurrimit dhe të shkollimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", i ndryshuar, bazuar në propozimin me nr. 1430/5 prot., datë 04.03.2025 të Ministrisë së Brendshme, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Pika nr.1 e Vendimit të Senatit Akademik të UMT-së nr.130, datë 13.12.2024, i ndryshuar, bëhet si më poshtë:

"Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2024-2025, janë në total 316 (treqind e gjashtëmbëdhjetë)".

2. Pika nr. 2 e Vendimit të Senatit Akademik të UMT-së nr.130, datë 13.12.2024, i ndryshuar, bëhet si më poshtë:

"Kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr. 1, të përditësuar, bashkëlidhur këtij vendimi".

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë përgjegjëse për arsimin.

KRYETARI
Prof. Dr. Xheladin DRACINI




Tabela nr. 1 (e përditësuar). Kuotat e pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve “Specializim Afatgjatë” në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2024-2025.

Nr.	NJËSIA KRYESORE	PROGRAMI I STUDIMIT	KUOTA TË MIRATUARA PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025
1	F. MJEKËSISË	ALERGOLOGJI DHE IMUNOLOGJI KLINIKE	5
2	F. MJEKËSISË	ANATOMI PATOLOGJIKE	5
3	F. MJEKËSISË	ANESTEZI-REANIMACION	20
4	F. MJEKËSISË	DIAGNOZË ME IMAZHE	11
5	F. MJEKËSISË	DERMATOLOGJI DHE VENEROLOGJI	5
6	F. MJEKËSISË	ENDOKRINOLOGJI	5
7	F. MJEKËSISË	GASTROHEPATOLOGJI	7
8	F. MJEKËSISË	HEMATOLOGJI	5
9	F. MJEKËSISË	KARDIOKIRURGJI	5
10	F. MJEKËSISË	KARDIOLOGJI	8
11	F. MJEKËSISË	KIRURGJI E PËRGJITHSHME	20
12	F. MJEKËSISË	KIRURGJI PLASTIKE, RIKOSTRUKTIVE DHE ESTETIKE	5
13	F. MJEKËSISË	LABORATOR KLINIK-BIOKIMIK	5
14	F. MJEKËSISË	MIKROBIOLOGJI	5
15	F. MJEKËSISË	MJEKËSI FAMILJE	30
16	F. MJEKËSISË	MJEKËSI INTERNE	10
17	F. MJEKËSISË	MJEKËSI LIGJORE	5
18	F. MJEKËSISË	MJEKËSI URGJENCE	15
19	F. MJEKËSISË	MJEKËSI TRANSFUZIVE	5
20	F. MJEKËSISË	NEFROLOGJI	7
21	F. MJEKËSISË	NEUROLOGJI	5
22	F. MJEKËSISË	NEUROKIRURGJI	5
23	F. MJEKËSISË	OTORINOLARINGOLOGJI	5
24	F. MJEKËSISË	OBSTETRIKË-GJINEKOLOGJI	10
25	F. MJEKËSISË	OKULISTIKË	5
26	F. MJEKËSISË	ONKOLOGJI	8
27	F. MJEKËSISË	ORTOPEDI-TRAUMATOLOGJI	5
28	F. MJEKËSISË	PEDIATRI	20
29	F. MJEKËSISË	PNEUMOLOGJI	5
30	F. MJEKËSISË	PSIKIATRI	10
31	F. MJEKËSISË	PSIKIATRI E FEMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE	5
32	F. MJEKËSISË	REUMATOLOGJI	5
33	F. MJEKËSISË	SËMUNDJE INFEKTIVE	10
34	F. MJEKËSISË	SHËNDET PUBLIK	10
35	F. MJEKËSISË	TOKSIKOLOGJI KLINIKE	5
TOTAL FM			296
1	F. MJEKËSISË DENTARE	KIRURGJI MAKSILO-FACIALE	10
2	F. MJEKËSISË DENTARE	ORTODONCI	5
TOTAL FMD			15

*5 kuota të miratuara për transferim të studimeve në Fakultetin e Mjekësisë UMT, nga institucione jashtë shtetit
5 kuota për transferim të studimeve për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale